



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2022:015156
Datë: 16.12.2024
Numri i dokumentit: 06599910

Kom.Dh.Shk.II.nr.601/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NHNI “Morava e Binçes” me seli në rr. “Xh. Ëashington” p.n, Gjilan të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, kundër debitorit N.T.P “Amish Presheva” Zona Industriale në Fushë Kosovë, për shkak të përmbarimit në të holla sipas dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.257/2022 të datës 28.02.2023, me datë 16.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit NHNI “Morava e Binçes” me seli në rr. “Xh. Ëashington” p.n, Gjilan të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.257/2022 të datës 28.02.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.257/2022 të datës 28.02.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.T.P “Amish Presheva” me seli në Fushë Kosovë, ka anuluar urdhrin përmbarimor E.nr. 323/10 datës 08.04.2010 lidhja P.nr.376/2019 i datës 11.10.2019 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Përparim Xhelili me seli në Gjilan, dhe e ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozimin që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e kreditorit, ashtu që të priset aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.257/2022 të datës 28.02.2023, dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Gjykata Ekonomike e Qarkut duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NHNI “Morava e Binçes” me seli në Gjiilan, ka caktuar urdhrin përmbartimor me numër E.nr. 323/2010 të datës 08.04.2010 duke lejuar duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Fatura Nr. 48/FB e datës 07.11.2018, situata e pestë përfundimtare nr. 183 e datës 05.02.2008 dhe kontrata mbi prodhimin e elementeve montazh nr.145 e datës 23.10.2007 dhe oferta për prodhimin e elementeve montazh prej betoni me dimensione 28/70 metra si dhe fleta llogaritëse nga sektori i financave i datës 04.03.2010 në bazë të cilave detyrohet debitori që kreditorit në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi t’ia paguaj borxhin e mbetur në shumën prej 5.870,33 euro me kamatë ligjore prej arritjes së pagesave të faturave e deri në pagesën definitive, me shpenzimet e procedurës përmbartuese, Gjykata Themelore në Prishtinë sipas konkluzionit me numër Cp-1886/19 të datës 07.10.2019, këtë çështje përmbartimore i dorëzon për procedim të mëtejshëm përmbartuesit privat Përparim Xhelili dhe merr numrin P.nr.376/2019 .

Debitori në prapësimin e paraqitur në kohë sipas ligjit, ka theksuar se detyrimi i debitorit ndaj kreditorit sipas Propozimit për Përmbartim është i pabazuar për arsye se debitori ka realizuar në tërësi obligimin ndaj kreditorit dhe këtë e dokumenton nëpërmes faturës – dëftesës nr.60/08 të datës 12.11.2008 në bashkëngjitje të prapësimi. Tutje, sipas debitorit propozimi i kreditorit është i kundërligjshëm sepse është parashtruar në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore meqenëse propozimi i tillë nuk përmban shënimet e kërkuara, emrin, adresën e saktë të vendbanimit, nuk përmban as numrin personal identifikues të debitorit, por është bërë në emër të personit juridik, pra mungon subjektiviteti. Me pas debitori ka shtuar se propozimi në mbështetje të nenit 71 pika 1.4 të LPP-së nr.04/L-139 është bërë pasi ka skaduar afati brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbartimi konform nenit 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve meqenëse kemi të bëjmë me afatin një vjeçare të parashkrimit të kërkesës si dhe sipas kontratës afati i përmblylles së punimeve ka qenë 60 ditë që i bie data e përfundimit 23.12.2007, ndërkaq propozimi është bërë 25.03.2010, dy vite pas përfundimit të punimeve sipas kontratës së cituar. Në fund, i propozon Gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe Aktvendimi - Urdhrin Përmbartimor i datës 11.10.2019 të Përmbartuesit Privat Përparim Xhelili të ndalohet dhe të anulohen të gjitha veprimet e kryera.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vepruar sipas prapësimi të debitorit, ka marr aktvendimin KPPP.nr.257/2022 të datës 28.02.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.T.P “Amish Presheva” me seli në Fushë Kosovë, ka anuluar urdhrin përmbartimor E.nr. 323/10 datës 08.04.2010 lidhja P.nr.376/2019 i datës

11.10.2019 të lejuar nga Përmbauesi Privat Përparim Xhelili me seli në Gjilan, dhe e ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbaimore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar drejtë gjendjen faktike kur kanë konstatuar se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbaimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbaimit nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit – faturës, propozimi ka përmbajtur të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen, ngase gjykata, në këtë fazë të procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë zbatuar kushtet ligjore nga Neni 37 i LPP-së, me të cilin parashihet se: *“Kur propozimi për përmbaimit paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbaimore, respektivisht është lejuar përmbaimit nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se faturat nuk janë dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuara noteriale por vetëm si kopje më pas të vulosura nga kreditori e të cilat nuk mund të pranohen si fatura origjinale.

Dhomat e shkallës së Dytë i ka trajtuar pretendimet ankimore të kreditorit se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e përfshirë me shkelje esenciale, mirëpo vlerësoi se nuk qëndrojnë pretendimet për shkelje absolute. Në këtë drejtim, kjo Gjykatë gjeti se dispozitivi është i rregullt dhe i njëjti nuk mund të jetë i paekzaminueshëm. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me të drejtë në dispozitivin e aktvendimit ka anuluar urdhrin përmbaimitor E.nr.323/10 të datës 08.04.2010 të lidhur edhe me numrin që lënda ka marr me rastin e transferimit tek Përmbauesi Privat. Është esenciale të theksohet se propozimi për përmbaimit përmban vulën e pranimit të Gjykatës së Qarkut e cila në kuptim të ligjit paraqet urdhër përmbaimitor, ndërkaq siç pretendon kreditori – aktvendimi përmbahet në propozim, i cili validohet vetëm me rastin e urdhrit nga

organi përmbarues. Në rastin konkret fakti se kreditori ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të transferojë çështjen tek përmbaruesi privat, evidentohet se vetëm me rastin e transferimit debitori është njoftuar me të drejtën për parashtrim të prapësimit. Rrjedhimisht, nuk qëndron pretendimi ankimor se aktvendimi i gjykatës është bërë *res judicata*. Në këto rrethana kjo Gjykatë vlerëson se debitori ka shfrytëzuar mjetin juridik për herë të parë pasi që është njoftuar nga përmbaruesi privat dhe ka atakuar urdhrin përmbarimor. Është e rëndësishme se dispozitivi përmban numrin e urdhrit përmbarimor si atë të gjykatës, ashtu edhe ndërlidhjen me numrin që ka marr tek përmbaruesi. Së këndejmi, pretendimet ankimore në aspektin teknik të përpilimit nuk e bëjnë të bazuar ankesën.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.601/23 dt. 16.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova